

SHËNDETI I TË HUAJVE HYRJE

Çfarë është asistencë shëndetësore?

Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar lejon që:
të zgjidhet një mjek në listën e atyre që veprojnë në komunën e vendbanimit të cilit ti drejtoheni për probleme shëndetëse. Mjeku do të vizitojë dhe do të mund të tregojë mjekimet e nevojshme (ilaçet, etj), të kërkojë vizita të mëtejshme pranë mjekëve të specializuar, të kërkojë analiza laboratorit, të kërkojë shtrime në spital.

Si mund të merret asistencë shëndetësore?

NËSE VJEN NGA NJË VEND I BASHKIMIT EVROPIAN (Austri, Belgjik, Bullgari, Çipro, Danimark, Estoni, Finland, Franc, Gjermani, Greqi, Itali, Letoni, Lituani, Luksenburg, Malta, Vendet e Ulta, Poloni, Portugali, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut, Republika Çeka, Rumani, Republika Sllovaqe, Republika e Irlandës (EIRE), Slloveni, Spanjë, Svecia, Hungeri), **e Hapësirës Ekonomike Evropiane** (Island, Liechtenstein dhe Norvegji) **dhe nga Zvicëra** duhet të keni tesian evropiane të SIGURIMIT PËR SËNDETI (SËMUNDJE) (TEAM) e lëshuar nga vendi i prejardhjes (ose një dokument i barasvlershëm për Shtetet Evropian në të cilat, edhe kalimtarisht, nuk është akoma e futur).

Me Tesian evropiane ose një zëvendësuese mund të hyni drejtpërdrejt në strukturat shëndetësore (p.sh: mjeku i familjes, konsultore, ndihma e shpejtë) dhe të merrni kujdesjet shëndetësore që janë të nevojshme gjatë qëndrimit të përkohshëm (si p.sh për turizëm)

Në mungesë të TEAM ose një dëshmie tjetër shtetasi komunitar duhet të paguajë plotësisht tarifat të lidhura me kurimet e marra. Mund më pas të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga institucionet e shtetit të tij në momentin e hyrjes në shtetin nga vjen.


Nëse shtetasi komunitar qëndron në territorin kombëtar për një periudhë më të madhe se 3 muaj mund të regjistrohet falas në SSN në rastet e më poshtme:

1. nëse është një puntorë i varur ose autonom për shtetin;
2. nëse është një familjar i një puntori të varur ose autonom edhe pse jo komunitar
3. nëse është një familjar i një shtetasi italian
4. nëse ka një leje qëndrimi të përkohshme prej më shumë se 5 vjet
5. nëse është i pa punë dhe i regjistruar në listën e pritjes ose i regjistruar në ndonjë kurs formimi profesional
6. është titullar i një prej formularëve në vazhdim: E106, E109(o E37), E121 (o E33)

KUSH JANË FAMILJARËT E NJË SHTETASI TË BASHKIMIT EVROPIAN QË MUND TË REGJISTROHEN NË SSN.

- bashkëshorti/ja
- fëmijët më të vegjël se 21 vjet të shetasit komunitar, të bashkëshortit / es dhe fëmijët më të mëdhenj se 21 vjet;
- prindërit në ngarkim të shetasit komunitar dhe prindërit në ngarkim të bashkëshortit/es;

Shtetasve të bashkimit evropian të pranishëm në territorin kombëtar dhe pa sigurim shëndetësor duke qenë se nuk mund të regjistrohen në SSN dhe jo të mbështetur nga shteti që vijnë(duke mos patur mbështetjen e TEAM) ju sigurohen shërbimet që nuk mund të shtyhen për më vonë dhe ato



urgjente, ndër të cilat hyjnë shërbimet shëndetësore të lidhura me mbrojtjen e shëndetit të të miturve dhe mbrojtjen e shtatzënisë.

NËSE NUK VJEN NGA NJË VEND I BASHKIMIT EVROPIAN:

A) NËSE KE LEJEN E QËNDRIMIT të lëshuar për punë të varur, punë sezonale, punë autonome, arsye familjare, strehim politik, strehim humanitar, kërkesë strehimi, pritje për adoptim dhe besim, marrje e shtetësisë) **OSE NËSE PUNON** ose je i regjistruar në Qendrat për nëpunësi (edhe me leje qëndrimi për arsye të tjera) mund të regjistrohesh në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar duke paraqitur lejen e qëndrimit në USL - Zyrën SAUB të Distriktit të vendbanimit-banesës.

Të regjistruarve në SSN do t'ju lëshohet një TESERË SHËNDETËSORE pa pagesë për të gjithë kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit.

NËSE KE LEJEN E QËNDRIMIT TË LËSHUAR PËR "KURIME MJEKËSORE" DHE JE SHTATZËNË OSE KE LINDUR NGA MË PAK SE GJASHTË MUAJ:

Leja e qëndrimit për "KURIME MJEKËSORE" lëshuar **grave në gjendje shtatzënie ose në gjashtë muajt pas lindjes së fëmijës** për të cilin kujdesen, jep të drejtën e regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar dhe të lëshimit të taserës shëndetësore për vlefshmërinë e lejes të qëndrimit, pas paraqitjes të një certificate të Konsultores të AUSL-it që dëshmon shtatzëninë ose lindjen e fëmijës.

B) NËSE KE LEJEN E QËNDRIMIT me vlefshmëri mbi tre muaj dhe nuk bën pjesë në ato të parashikuar në pikën A), dhe nuk ke një sigurim për shëndetin (sëmundje), aksident etj, mund të marrësh taserën shëndetësore duke paguar një kontribut vjetor i përcaktuar si më poshtë:

- Euro 387,34 për qytetarët e huaj me familjarë në ngarkim (përfshirë edhe kategorinë e studentëve me familjarë në ngarkim);
- Euro 149,77 për të huajt që qëndrojnë për arsye studimi pa familjarë në ngarkim;
- Euro 219,49 për të huajt që punojnë "alla pari"(domethënë që punojnë pranë familjeve si ndihmës në punët shtëpiake në shkëmbim të banesës dhe ushqimit);

Tesera është e vlefshme nga momenti i lëshimit deri me 31 dhjetor të vitit në vazhdim. Mund të regjistrohen vullnetarisht në SSN duke paguar kontributin vjetor të huajt, për shembull, me leje qëndrimi të lëshuar për banim elektiv, arsye fetare, studentat dhe personat që punojnë "alla pari". Vetëm për studentat dhe për personat "alla pari" leja e qëndrimit mund të jetë me një zgjatje më të ulët se tre muaj.


Regjistrimi vullnetar në SSN ka vlerë për një vit diellor (janar – dhjetor), nuk mund të copëzohet, nuk ka fuqi të prapme dhe nuk është e lejuar për qytetarët e huaj që kanë lejen e **qëndrimit për arsye kurimit, për arsye turizmit dhe biznesit.**

C) NËSE NUK KE LEJEN E QËNDRIMIT sepse je I PRANISHËM I PARREGULLT në territorin kombëtar dhe ke nevojë për kurime shëndetësore, atëherë do të të jepet **TESERA STP** nga shërbimi **publik** në të cilin je drejtuar.

TESERA SHËNDETËSORE

Është dokumenti që vërteton regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN) dhe lejon që të merren shërbimet shëndetësore dhe të hyhet në shërbimet.

Për të marrur taserën shëndetësore duhet paraqitur në USL - ZYRA SAUB e Komunës të vendbanimit dhe të paraqitet leja e qëndrimit e vlefshme.



Vërtetime të mëtejshme që mund të nevojiten, do të autodeklarohen ose të paraqiten te operatori i sportelit ashtu si për qytetarët italian.

Regjistrimi në SSN garanton barazim trajtimit dhe barazim të plotë të të drejtave dhe detyrimeve ashtu si qytetarët italian për sa i përket asistencës shëndetësore të furnizuar.

Njëlloj si qytetarët italian të huajt në zotërim të teserës shëndetësore janë të detyruar të paguajnë ticket-in nëse duhet.

Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar jep mundësinë që të merret një MJEK I FAMILJES. Zgjedhja e mjekut të familjes bëhet pranë zyrës që lëshon teserën shëndetësore, duke këshilluar listën e mjekëve të disponueshëm. Fëmijët nga 0 deri në 14 vjeç kanë të drejtë të kenë falas një mjek specialist pediatër. Lista të posaçme ekzistojnë edhe për zgjedhjen e pediatrit. Emri i mjekut të familjes shkruhet në taserën shëndetësore përkatëse. Mjeku i familjes mund të ndërrohet ose të zëvendësohet në çdo moment.

Mjeku i familjes dhe pediatri garantojnë falas:

- vizita ambulatoriale dhe shtëpiake,
- porosi të ilaçeve,
- porosi të analizave të gjakut,
- porosi të analizave radiologjike,
- porosi të shtrimit në spital
- lëshojnë certificata të sëmundjeve për punonjës të varur dhe për fëmijët që duhen të hyjnë në shkollë pas një periudhë sëmundjet.

Mund ti drejtoheni mjekut të familjes edhe për të marr këshilla dhe sugjerime për të mbrojtur shëndetin, duke parandaluar shfaqjen e sëmundjeve. Mjeku dhe pediatri i familjes zhvillojnë aktivitetin e tyre në oraret dhe ditët e sinjalizuara në këndin e lajmërimeve të ekspozuara në ambulatorët.

TESERA STP (I huaji i pranishëm për kohësisht)

Për të huajt pa leje qëndrimi, jo në rregull me normat në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin në Itali, asistencë shëndetësore garantohehet nëpërmjet lëshimit të një tesere STP (I huaji i pranishëm **për kohësisht**).


Tesera STP garanton furnizimin e shërbimeve shëndetësore të mëposhtme:

- mjekimet ambulatoriale dhe spitalore urgjente dhe të domosdoshme, edhe të vazhdueshme, për sëmundje dhe aksidente;
- programe të mjekësisë parandaluese;
- mbrojtja e shtatzënisë dhe e amësisë;
- mbrojtja e shëndetit të të miturve;
- vaksinat e detyrueshme;
- ndërhyrjet e profilaksit ndërkombëtar;
- profilaksi, diagnoza dhe mjekimi i sëmundjeve ngjitëse;
- mjekimi dhe rehabilitimi i gjendjeve të toksikomanisë;

Tesera/kodi STP është e lëshuar nga Ndërmarrja USL dhe nga Ndërmarrja Spitalore në pikat e hyrjes të parë (Ndihmë e shpejtë, Konsultore, sportele SAUB, etj.).

Tesera STP ka vlerë 6 muaj mbi të gjithë territorin italian dhe mund të përtëritet në rast të qëndrimit të të huajit. Mund të lëshohet një kopje e dytë në rast se i huaji është pa të.

Një qytetarë i huaj pa dokumenta të rregullta është i detyruar të paguaj shërbimet e furnizuara sipas tarifave të përcaktuara nga Krahinat, veç në mos të jetë pa pasuri ekonomike të mjaftueshme dhe të lëshojë një deklaratë të shkruar në lidhje me kondicionet e ti si i varfër; edhe se i varfër duhet të paguaj sidoqoftë ticket-in nëse duhet.



ËSHTË E NDALUAR STRUKTURAVE SHËNDETËSORE TË SINJALIZOJNË AUTORITETEVE TË POLICISË PRANINË E TË HUAJVE pa dokumenta tw rregullta DHE/OSE KLANDESTINA PËRVEÇ RASTEVE NË TË CILAT ËSHTË I DETYRUESHËM RAPORTI I MJEKUT (në të njëjtat raste të parashikuara për qytetarët italian).

RASTE TË VEÇANTA:

TË HUAJ ME LEJE QËNDRIMI PËR TURIZËM

Qytetari në zotërim të lejes të qëndrimit për turizëm është i detyruar të hartojë një policë sigurimit që të mbulojë edhe shpenzimet e rrjedhura nga shërbime/shtrime në spital të mundshme. Në mungesë të policës të sigurimit duhet të paguhen shtrimet në spital ose shërbimet ambulatoriale sipas tarifave në fuqi.

I HUAJI QË DËSHIRON TË KUROHET NË ITALI:

Kush ka nevojë të vij në Itali për tu kuruar, duhet të ketë një leje qëndrimi të posaçme për “kurime mjekësore”. Për të marr vizën e hyrjes duhet të paraqitet në Ambasadën italiane ose në Konsullatën kompetente territorialisht në Vendin e prejardhjes dokumentet e mëposhtme:

- një deklaratë e strukturës të përzgjedhur, publike ose private konvencionale, ku të jetë i treguar tipi i kurimit dhe zgjatja e përafërt e kurimit;
- derdhja pranë strukturës të një shume si garanci baras me 30% e çmimit të përgjithshëm të supozuar për shërbimin r kërkuar;
- dokumente që provojnë dispozicionin e pasurive të mjaftueshme për pagesën e plotë të shpenzimeve shëndetësore të mbetura, të shpenzimeve të ushqimit, të fjetjes jashtë strukturës shëndetësore dhe riatdhesimit për vete dhe për shoqëruesin eventual;
- **Certifikat mjekësore (raport) e cila dëshmon patologjinë. Certifikata (mjekësore) e lëshuar jashtë shtetit duhet të jetë e përkthyer në gjuhën italiane.**

EKSTRAKOMUNITAR TË MITUR ME QËNDRIM TË SHKURTËR TË STREHUAR NË SHOQATAT VULLNETARE

Në rrethin e iniciativave të nxitura nga Krahina Emilia Romagna (shembull: pritja e fëmijëve të Chernobyl, Saharaëi) çdo vit mbërrijnë në provincën tonë, nëpërmjet organizatave vullnetare, fëmijë të huaj për qëndrime pak ose shumë të gjata. Këto fëmijë janë të regjistruar në SSN pranë USL – Zyra SAUB të Komunës në të cilën banojnë. Atyre dhe shoqëruesve përkatës (një çdo 15 fëmijë të strehuar) i lëshohet një tesar shëndetësore për periudhën e kohëzgjatjes të lejes të qëndrimit që përmban emrin e pediatrit ose të mjekut të familjes të zgjedhur.

Siti zyrtar që të vizitohen: www.governo.it/GovernoInforma/Dossier/stranieri_sanita/stranieri_ue.html